



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

01.02.2012

## Titull: Menaxhmenti i AKP-së u takua me drejtuesit e OEK-ut

**Prishtinë** - Drejtori menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, z. Shkelzen Lluka, i shoqëruar nga zëvendësdrejtorët znj. Mrika Tahiri dhe z. Naim Avdiun, kanë vizituar sot Odën Ekonomike të Kosovës dhe janë pritur nga drejtuesit e këtij institucioni, me të cilët është biseduar për mundësitë për një bashkëpunim më të mirë në mes të dy institucioneve të rëndësishme të Republikës së Kosovës.

Drejtori i AKP-së, z. Lluka ka vlerësuar se ky takim ishte në vazhden e bashkëpunimit dhe konsultimeve të vazhdueshme që AKP ka me OEK-un dhe me udhëheqjen e saj.

“Ne sot e informuam kryetarin e Odës mbi angazhimet e AKP-së për ketë vit si dhe sfidat që na presin në të ardhmen. AKP së shpejti, me datën 10 të këtij muaji do të bëjë edhe hapjen e ofertave për angazhimin e autoriteti të likuidimit. Afatet ligjore në të kaluarën kanë qenë të tejzgjata, tani maksimumi i tërë shqyrtimit të këtyre kërkesave me ndryshimet ligjore është 18 muaj. Një çështje tjetër është se këtë vit do të merremi edhe me Trepçën. Ne kemi filluar me shpalljen e moratoriumit mbi Trepçën, pasi që në bazë të legjislacionit aktual, Agjencia është administratori i vetëm i Trepçës. Kemi një bashkëpunim të ngushtë edhe me ministritë përkatëse që merren me zhvillimin ekonomik dhe me menaxhmentin e Trepçës”, deklaroi drejtori menaxhues i AKP-së, z. Shkelzen Lluka. Ai tha se vazhdimisht e informojnë Odën Ekonomike dhe udhëheqjen e saj mbi rrjedhat dhe punën e AKP-së, pasi që OEK -u është urë ndërlidhëse në mes të institucioneve të komunitetit të biznesit në Kosovë.

Ndërsa kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, z. Safet Gërgjaliu njoftoi se gjatë takimit është biseduar në veçanti për formën e bashkëpunimit dhe involvimit të sektorit privat në procesin e privatizimit, sidomos kur bëhet fjalë për likuidimin e ndërmarrjeve shoqërore.

“U bisedua për cilësinë e legjislacionit, të cilin vërtet me një mund të pafund z. Lluka me bashkëpunëtorë ka arritur ta vëjë në funksion dhe me një angazhim permanent sot reflekton pozitivisht. Legjislacioni aktual i AKP është i kosovarizuar dhe përveç asaj që shumë ndërmarrje të tjera kanë pasur benefite pozitive, ajo çka edhe kosovarët i bënë më të qetë është një qasje shumë më pragmatike, një qasje shumë më serioze dhe një qasje vizionare sa i përket të ardhmes së Trepçës”, tha kryetari i OEK-ut, z. Gërxhaliu.

Ai tha se debati lidhur me Trepçën është shumë i rëndësishëm për faktin se Trepça ka potenciale natyrore dhe rëndësi ekonomike, sociale dhe strategjike për vendin.

Në lidhje me Trepçën, drejtori i AKP-së, z. Shkelzen Lluka tha se të martën (me datë 31 janar 2012) është konfirmuar nënshkrimi i një marrëveshjeje me Ministrinë e Financave të Gjermanisë për asistencë teknike për të kryer një studim të fizibilitetit, ndërkohë që u shpreh



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

me shpresë se shpejt do të përfundoj edhe plani për riorganizimin dhe rivitalizimin e Trepçës.

**FUND**

Rr. Ilir Konushevc No.8,  
10 000 Prishtina, Kosovë,  
Tel: 038 500 400,  
E-mail: [info@pak-ks.org](mailto:info@pak-ks.org),  
[www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)